

NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË

RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2024-2025

Tiranë, Shtator 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	3
1.1 Sfondi i përgjithshëm	3
1.2 Korniza rregullatore	4
2. FUNKSIONI DHE ROLI NJBSC	6
3. AKTIVITETI VJETOR	8
3.1 Rritja dhe forcimi i kapaciteteve të stafit të NJBSC	8
3.1.1 Trajnime në kuadër të projekteve ndërkombëtare	8
3.2 Vlerësimi i performancës akademike	10
3.3 Ndërkombëtarizimi	18
3.4 Akreditime	19
3.5 Dixhitalizimi	20
3.6 Kërkimi Shkencor	21
3.7 Rishikimi kurrikulave	Error! Bookmark not defined.
4. REKOMANDIME	21
5. ANEKSE	23

1. HYRJE

1.1 Sfondi i përgjithshëm

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është thelbësore për ruajtjen e përsosmërisë akademike, efikasitetit operacional dhe një reputacioni të fortë brenda institucioneve të arsimit të lartë. Nëpërmjet standardizimit të proceseve, sigurimit të pajtueshmërisë me standardet e akreditimit të ASCAL dhe ato të përshkruara në ESG, si dhe duke nxitur përmirësimin e vazhdueshëm, kjo njësi luan një rol kryesor në rritjen e cilësisë në mësimdhënie, kërkim-shkencor dhe administrim. Nëpërmjet Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë nxitet llogaridhënia, mbështetet vendimmarrja e bazuar në të dhëna dhe përafrohen aktivitetet e universitetit me qëllimet strategjike të tij. Për më tepër, NJSBC-ja kontribuon në arritjen e rezultateve më të mira nga studentët, tërheq talentet e reja dhe mbron qëndrueshmërinë afatgjatë të institucionit, duke i bërë këta komponentë të domosdoshëm për arritjen e suksesit. Sigurimi i cilësisë mbetet kritik për aq kohë sa IAL-të zhvillohen duke përvetësuar praktika të reja të mësimdhënies dhe të të nxënit, zhvillohen modele të reja institucionale dhe tentojnë të zgjerojnë aksesin dhe barazinë në arsimin e lartë. Natyra dinamike e arsimit të lartë, veçanërisht në një kontekst gjithnjë e më të globalizuar, kërkon korniza të fuqishme të sigurimit të cilësisë që kanë aftësi të përshtatën ndaj ndryshimit duke ruajtur standarde të larta, në përputhje me parimet e përcaktuara në ESG. Bazuar në një rishikim gjithëpërfshirës të literaturës, rolet kryesore të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përfshijnë sigurimin e përputhshmërisë me standardet kombëtare të cilësisë, mbështetjen në arritjen e qëllimeve institucionale, përcaktimin dhe vlerësimin e rezultateve të të nxënit dhe rritjen e transparencës dhe vlerës së sistemeve të kualifikimit. Kjo njësi gjithashtu ka për detyrë të rrisë cilësinë e përgjithshme të ofertës akademike, të ofrojë mundësi për vetë-reflektim dhe vetëvlerësim dhe të mbështesë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë përmes një cikli të vazhdueshëm përmirësimi. Për më tepër, ai ofron informacion thelbësor mbi cilësinë brenda dhe jashtë institucionit, nxit kënaqësinë e studentëve dhe mbështet proceset e vendimmarrjes të informuara brenda IAL-së. “Sigurimi i cilësisë është thelbësor për ruajtjen e këtyre vlerave në tri mënyra domethënëse: së pari, duke përforcuar vizionin se arsimi i lartë bazohet në këto vlera thelbësore; së dyti, duke shërbyer si një sistem kritik mbështetës për këto vlera në mijëra universitete dhe ofrues arsimor në zhvillim në mbarë botën; dhe së treti, duke vepruar si zë për studentët dhe shoqërinë, duke theksuar se si cilësia e arsimit të lartë është vizioni për integrimin e këtyre vlerave. Arsimi në Evropë udhëhiqet nga tre misione themelore: mësimi dhe mësimdhënia, kërkimi dhe shërbimi ndaj shoqërisë.” (Eatson, 2021)

1.2 Korniza rregullatore

Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë është një proces thelbësor që garanton që universitetet dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë përmbushin standardet e vendosura nga organet e akreditimit, autoritetet qeveritare dhe organizatat profesionale. Qëllimi kryesor i institucioneve të arsimit të lartë është ofrimi i një arsimi cilësor që përgatit studentët për tregun e punës dhe studime të mëtejshme, ndërsa njëkohësisht i pajis institucionet me mjete dhe mekanizma efektivë për përmirësim të vazhdueshëm. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë në Universitetin POLIS mbështetet në tri shtylla kryesore, me qëllim garantimin e koherencës dhe efektivitetit. Duke u mbështetur në këto tri shtylla kryesore, NJBSC synon që aktiviteti saj të jetë në përputhje të plotë me praktikat më të mira dhe standardet ndërkombëtare, duke lehtësuar përmirësimin e vazhdueshëm si dhe integrimin në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA). Kjo qasje siguron që të gjitha përpjekjet në fushën e sigurimit të cilësisë të jenë kohezive dhe të mbështesin qëllimin kryesor të ruajtjes së standardeve të larta të cilësisë akademike dhe efikasitetit operacional. Tri shtyllat kryesore mbi të cilat NJBSC bazohet për të ushtruar aktivitetin e saj janë:

- **Kërkesat ligjore**

Sigurimi i brendshëm i cilësisë është një detyrim ligjor i institucioneve të arsimit të lartë, të cilat janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e cilësisë. Ky sistem vendoset nga institucionet e arsimit të lartë dhe funksionon përmes Njesisë së Sigurimit të Cilësisë. Struktura dhe funksionet e kësaj njësie përcaktohen në statutet e institucioneve të arsimit të lartë (IAL). Aktiviteti NJBSC kryhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore si më poshtë:

- *Ligji Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Nenet 46, 103, 104 dhe 106¹;*
- *Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë, i miratuar me VKM nr. 824, datë 24.12.2021, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”²;*
- *Statuti i çdo institucioni të arsimit të lartë;³*
- *Manuali i Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për sistemin e brendshëm të cilësisë⁴.*

¹ <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/07/22/80>

² <https://www.ascal.al/media/documents/legjislacioni/VKM%20Nr.824,%20date%2024.12.2021%20Per%20miratimi%20e%20Kodit%20te%20Cilesise%20se%20Arsimit%20te%20Larte.pdf>

³ https://universitetipolis.edu.al/ep-content/uploads/2023/03/1_Statuti_POLIS.pdf

⁴ <https://www.ascal.al/media/documents/publikime/Manual%20afatet%20e%20akreditimit%20IAL%20dhe%20prog%20ramet%202017.pdf>

- **Standardet Europiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG)⁵**

Në kuadër të Standardeve dhe Udhëzimeve Evropiane, veçanërisht në përputhje me Standardet I.2, I.3, I.4, I.5, I.6 dhe I.7, NJSBC synon të nxisë më tej aspektet e mëposhtme:

- Miratimi, monitorimi dhe rishikimi periodik i programeve (Standard I.2 -Pjesa 1, ESG_2015);
- Të nxënit, mësimdhënia dhe vlerësimi me në qendër studentin (Standardi I.3-ESG_2015);
- Monitorimi i vazhdueshëm dhe rishikimi periodik i programeve.

- **Strategjia e Zhvillimit të Universitetit POLIS 2021-2026⁶**

Integrimi i praktikave të sigurimit të cilësisë me objektivat strategjike të Universitetit POLIS, në mbështetje të misionit dhe vizionit të tij. Strategjia e Sigurimit të Cilësisë Akademike në çdo institucion të arsimit të lartë duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë të gjitha aspektet kritike për ruajtjen e standardeve akademike dhe sigurimin e përmirësimit të vazhdueshëm. Një kërkesë kyçe e ESG-së është integrimi i kësaj strategjie me qëllimet e përgjithshme të institucionit, duke u fokusuar në dy fusha kryesore:

- *përputhja me objektivat strategjike* – standardi ESG 3.1 thekson që politikat e sigurimit të cilësisë duhet të jenë në harmoni me objektivat strategjike të institucionit. Kjo siguron që të gjitha proceset e sigurimit të cilësisë të mbështesin dhe forcojnë misionin dhe vizionin e institucionit.
- *qasja bashkëpunuese* – sipas Standardit ESG 3.2, sigurimi i cilësisë duhet të integrohet në aktivitetet e përgjithshme të institucionit. Ky integrim promovon bashkëpunimin midis NJSBC dhe njësive kryesore, njësive bazë dhe strukturave të tjera të pavaruara, duke krijuar një qasje të unifikuar për sigurimin e cilësisë në të gjithë universitetin.

Aktualisht Strategjia e Zhvillimit të Universiteti POLIS për periudhën 2021-2026 bazohet në 6 drejtime kryesore (strategjia didaktike, strategjia kërkimore, strategjia ndërkombëtarizimi, strategjia digjitalizimi, strategjia financiare) për të cilat janë vendosur objektivat dhe hartuar planet e implementimit për përmbushjen e tyre. Në përputhje me kërkesat e ESG 3.1 dhe ESG 3.2, në Universitetin Polis, ky integrimi realizohet nëpërmjet Strategjisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila është hartuar në përputhje me kornizat kryesore ndërkombëtare të cilësisë ESG 2015, si dhe aktet ligjore kombëtare të arsimit të lartë dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë.

⁵ https://www.enqa.eu/ep-content/uploads/2015/11/ESG_2015.pdf

⁶ https://universitetipolis.edu.al/ep-content/uploads/2022/10/U_POLIS-DEVELOPMENT-STRATEGY-1.pdf

Kjo qasje siguron një sistem të fortë dhe gjithëpërfshirës të sigurimit të cilësisë, i cili jo vetëm mbështet qëllimet institucionale, por gjithashtu përputhet me integrimin rajonal në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA). Sipas kësaj strategjie, NJSBC në Universitetin POLIS kryen “vlerësimin e cilësisë” si në tërësinë institucionale ashtu edhe të programeve të studimit duke përdorur ciklin Plan-Do-Check-Act. Për më shumë detaje referohu aneksit “Startegjia e Zhvillimit dhe Strategjia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

2. FUNKSIONI DHE ROLI NJBSC

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) në Universitetin POLIS, funksionon në përputhje me përcaktimet e ligjit për arsimin e lartë në fuqi, akteve nënligjore në zbatim të tij, udhëzimeve të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, statutin e Universitetit POLIS, objektivat strategjike institucionale, si dhe standardet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë evropian (ESG) me qëllim përafrimin e praktikave me standardet e vendosura ndërkombëtare të cilësisë për të mbështetur përsosmërinë akademike.

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë⁷ është konceptuar si një njësi e përhershme, e pavarur, e cila nëpërmjet funksionit të saj kryesor, vlerësimit të cilësisë, synon përmirësimin, rritjen e cilësisë, nxitjen dhe inkurajimin e aktorëve të cilët marrin pjesë në ofertën akademike në mënyrë që të shihet çdo aspekt me syrin e cilësisë, me krijimin dhe konsolidimin e kulturës së cilësisë në POLIS. Zhvillimi institucional, rritja e gamës së ofertës akademike të POLIS, si dhe dalja e studentëve në tregun e punës, përbëjnë një sfidë serioze dhe vënë në provë cilësinë e programeve akademike dhe rezultateve të mësimnxënies. Pavarësisht emërtimeve të njësisë ndër vite, qëllimet e NJBSC kanë qenë të njëjta, fokusuar kryesisht në vlerësimin e performancës në procesin mësimor si për stafin akademik ashtu edhe për komponentë të tjerë të lidhur me procesin si bibliografia dhe materialet e studimit, infrastruktura dhe llogjistika. Sipas Vendimin e Senatit nr. 14, datë 26.08.2024, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë përbëhet nga:

⁷ <https://universitetipolis.edu.al/njesia-e-brendshme-e-sigurimit-te-cilesise/>

Nr.	Emër Mbiemër	Roli	Pjesë prej vitit
1	Dr. Emi Hoxholli	Kryetare e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë	2024
2	Prof. As. Merita Guri	Anëtar	2018
3	Dr. Endri Duro	Anëtar	2024
4	Marsela Demaj	Anëtar	2024
5	Xhoi Musliaka	Anëtar	2024
6	Anjeza Dajzmaili	Anëtar (përfaqësues i stafit administrativ)	2021
7	Fiona Pirushi	Anëtar (përfaqësues i studentëve)	2024
8	Gjergji Dushniku	Anëtar (përfaqësues nga komuniteti Alumni)	2017
9	Enxhi Cerpia	Anëtar (përfaqësues nga komuniteti i biznesit – Alumil Albania)	2024

Tabela nr. 1 Përbërja e NJSBC-së për vitin akademik 2024-2025

Në përbërje të saj ka përfaqësues nga të tri fakultetet e Universitetit POLIS (FAD, FKZH, FPMMU) dhe të tri ciklet e studimit (bachelor, master dhe doktoraturë), si dhe pjestarë nga grupet e interesit (student, alumni dhe komuniteti i biznesit). Ky miksim bën të mundur realizimin me sukses të të gjithë fushave të veprimtarisë së NJSBC e cila është e rregulluar nga aktet e brendshme:

1. Rregullore e NJBSC⁸;
2. Strategjia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë 2023-2027⁹
3. Plani i Veprimit dhe Qëndrueshmërisë të NJBSC 2023-2027
4. Plani Vjetor i punës 2024-2025

Në funksion të përmbushjes së kërkesave që rrjedhin nga kuandri ligjor – rregullator, ESG dhe në përputhje me misionin, vizionin, objektivat strategjik të përcaktuar për periudhën afatmesme në Startegjinë e Zhvillimi të Universitetit, NJBSC ka parashikuar në Planin e Veprimit dhe Qëndrueshmërisë të NJBSC për 2023-2027, i cili bazohet në Strategjinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë 2023-2027 dhe Rregulloren e NJSBC, konkretisht në nenin 5 “Parimet themelore dhe

⁸ <https://universitetipolis.edu.al/ep-content/uploads/2024/04/Rregullore-NJBSC.pdf>

⁹ https://universitetipolis.edu.al/ep-content/uploads/2023/04/1.Internal_Quality_Assurance_Strategy_2023-2027_compressed.pdf

veprimtaria e Njesisë”, aktivitetet të paraqitura në mënyrë të përmbledhur në grafikun e mëposhtëm:




Figura nr. 1 Paraqitje grafike e shtyllave kryesore të aktivitetit të NJBSC parakishuar në Planin e Veprimit dhe Qëndrueshmërisë 2023-2027

3. AKTIVITETI VJETOR

3.1 Rritja dhe forcimi i kapaciteteve të stafit të NJBSC

3.1.1 Trajtime në kuadër të projekteve ndërkombëtare

Universiteti POLIS aktualisht është pjesë e projektit QA-SURE “Përmirësimi i Strategjive të Sigurimit të Cilësisë Universitare drejt Ekselencës”, i bashkë financuar nga Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian, bazuar në Marrëveshjen e Grantit nr. 101129398-ERASMUS-EDU-2024-CBHE-STRAND-1. Konsorciumi i projektit përbëhet nga 7 IAL, prej të cilave 5 IAL të Ballkanit Perëndimor dhe 2 IAL të Bashkimit Evropian. Projekti ka një kohëzgjatje prej 24 muajsh, prej datës 30.12.2023 deri më 30.11.2025 (<https://qa-sure.com/>) dhe synon trajnimin e stafit administrativ dhe akademik, si dhe të studentëve, mbi sigurimin e cilësisë për të garantuar

përgatitje dhe gjithë përfshirje më të mirë të produkteve administrative dhe akademike brenda IAL-ve partnere, veçanërisht kur bëhet fjalë për dizajnin e produktit të shërbimit dhe studimit.

A. Trajnimet e stafit akademik, administrativ dhe studentëve në kuadër të këtij projekti janë realizuar nga partnerët Sllovenë dhe Maqedonisë së Veriut sa më poshtë:

- Trajnim për stafin akademik nga Republika e Kosovës dhe Shqipëria në gusht 2024 në Shqipëri (Dr. Emi Hoxholli, Dr. Kledja Canaj, Dr. Flora Krasniqi, Msc. Erilda Muka, Msc. Marsela Jupas, Msc. Anjeza Dajzmaili, Msc. Anisa Sfrati);
- Trajnimi për stafin akademik nga Republika e Kosovës dhe Shqipëria në tetor 2024 në Republikën e Kosovës (Dr. Manjola Hoxha, Dr. Elona Karafili, Dr. Flora Krasniqi);
- Trajnimi i Studentëve në Shqipëri në Gusht 2024 (studentët në programin e doktoratë Kejsi Veselagu, Sadmira Malaj, Dejvi Dauti);
- Trajnim Administrativ për stafin administrativ nga Republika e Kosovës dhe Shqipëria në gusht 2024 në Republikën e Kosovës (Dr. Elona Karafili, Dr. Flora Krasniqi);
- Trajnim Administrativ për stafin administrativ nga Republika e Kosovës dhe Shqipëria në gusht 2024 në Shqipëri (Dr. Emi Hoxholli, Msc. Anjeza Dajzmaili);
- Webinar “Reviewing and Updating QA Policies to Align with ESG Standards” në Janar 2025, (Dr. Emi Hoxholli, Dr. Manjola Hoxha, MSc. Marsela Plyku).

Informacioni i detajuar lidhur me trajnimet e sipër përmendura gjendet i përmbledhur në dokumentin e publikuar në lidhjen https://qa-sure.com/wp-content/uploads/2024/12/WP4_Del-4.2-Trainings-on-Quality-Assurance.pdf

B. Për më tepër, si pjesë e projektit QA-SURE “Përmirësimi i Strategjive të Sigurimit të Cilësisë Universitare drejt Ekselencës”, (<https://qa-sure.com/>) anëtarët e NJBSC-së:

- Prof. Asoc. Merita Guri (staf akademik) dhe Msc. Anjeza Dajzmaili (staf administrative) kanë qenë pjesë e vizitës studimore në datat 15-16 Prill 2024 pranë South East European University në Tetovë, Maqedoni e Veriut.
- Anisa Gjini dhe Anisa Sfrati (staf administrative) kanë qenë pjesë e një vizite studimore në Slloveni për çështjet e cilësisë në datat 20-21 Qershor 2024;
- Marsela Plyku (stafi akademik) dhe Anjeza Dajzmaili (stafi administrative) kanë qenë pjesë e një vizite studimore në Slloveni, Piran EMUNI University për çështjet e cilësisë në datat 23-26 Mars 2025

Detaje mbi vizitat studimore janë të disponueshme në lidhjen https://qa-sure.com/wp-content/uploads/2024/12/WP4_Del-4.1_EU-Study-Visits.pdf

3.1.2 Trajnime në të brendshme në nivel institucional

Si pjesë e një politike të brendshme për rritjen institucionale, Universiteti POLIS nxit, identifikon dhe mbështet kualifikimin e mëtijshëm të stafit akademik duke ofruar trajnim të brendshëm (nëpërmjet angazhimit të ekspertëve të jashtëm vendas dhe të huaj). Përgjatë vitit akademik 2024-2025, me të gjithë stafin akademik dhe administrativ, u zhvilluar trajnimet sa më poshtë vijon:

- 16 Shtator 2024 – Prof.Dr.Myqerem Tafaj me temë “Arsimi i lartë, kërkimi shkencor dhe inovacioni: tendencat globale/europiane, dhe si pasqyrohen ato në Shqipëri”
- 17 Shtator 2024 – Geron Kamberi me temë “Strategjia dhe politikat e arsimit të lartë në Shqipëri”
- 18 Shtator 2024 - Prof. Dr. Dhurata Bozo me temë "Çështje aktuale në zhvillim të cilësisë kombëtare/europiane".

3.2 Vlerësimi i performancës akademike

Në përputhje me rregulloren e NJBSC-së, konkretisht nenin 6 “Procesi i vlerësimit të procesit mësimor”, i cili fokusohet në një prej detyrave më të rëndësishme të NJBSC-së, është dhe procesi i vlerësimit të cilësisë dhe performancës së stafit akademik ne procesin mësimor. Procesi i vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies të stafit akademik përbëhet nga 4 komponentë vlerësimi:

- *Vlerësimi nga studentët (pesha në vlerësimin total është 50%)*

Universiteti POLIS në filozofinë e vet, studentin e ka pasur gjithnjë në qendër të vëmendjes, duke e parë atë jo vetëm si student, por dhe si bashkëpunëtor në këtë rrugë të gjatë të ngritjes dhe përmirësimit të institucionit. Në përfundim të cdo semestri akademik marrja e mendimeve të studentëve mbi cdo program studimor në tërësi, lëndë të veçantë, pedagog apo mbi një problem specifik nëpërmjet pyetësorëve janë një e dhënë shumë e rëndësishme për përmirësimin e cilësisë në POLIS.

- *Vlerësimi nga kolegët (pesha në vlerësimin total është 35 %)*

Ky proces që ndryshe është emërtuar (vlerësim nga të barabartët) kryhet nëpërmjet ndjekjes së procesit mësimor nga kolegët.

- *Vetë-vlerësimi (pesha në vlerësimin total është 15%)*

Vetëvlerësimi i pedagogëve është gjykuar si një komponent që dëshmon për shkallën e njohjes që vetë pedagogët kanë për cilësinë dhe kulturën e cilësisë dhe shkallën e vetkritikës me synim përmirësimin e vazhdueshëm individual.

- *Vlerësim nga drejtuesit*

Vlerësimi i katërt është vlerësimi që realizohet përmes një procesi analize dhe feedback të kombinuar edhe me analizat semestrale. Gjithashtu vlerësimi që kryhet nga drejtuesit përmes ballafaqimeve e bisedave informale e plotëson kuadrin e vlerësimit nga këndvështrimi i pritshmërive të drejtuesve dhe kërkesave që kanë për cilësinë e aktivitetit akademik. Me stafin e ri ky proces përfshin dhe fokusohet në këshillim, orientim, njohjen me praktikatat më të mira me synim përmirësimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e sensit vetkritik. Ky vlerësim shërben si vlerësim

përfundimtar për performancën e përgjithshme të secilit staf akademik përfshi edhe punën shkencore dhe bazohet në rezultatet e vlerësimit të studentëve, kolegëve dhe të vetëvlerësimit.


Më synimin primar që procesi periodik i vlerësimit të mësimdhënies së stafit akademik të jetë sa më real dhe i painfluencuar, në përputhje me kalendarin e punës së NJSBC të miratuar në nisje të vitit akademik, vlerësimi u zhvilluar përkatësisht në tri javët e fundit të semestrit të parë (janar 2026) dhe tri javët e fundit të semestrit të dytë (maj 2025). NJSBC në muajin Nëntor 2024, nëpërmjet postës elektronike, kërkoi sugjerime nga secili dekanat, lidhur me përmirësimin e tri formularëve (shih Aneks 1 - 3) që janë pjesë e procesit të vlerësimit, më konkretisht:

- Formular vlerësimi nga studentët për stafin akademik (Aneksi nr. 1);
- Formular vlerësimi që kolegu realizon për kolegun (Aneksi nr. 2);
- Formular vetëvlerësimi (Aneksi nr. 3).


Gjithashtu, në kuadër të komponentit të vlerësimit "nga kolegu për kolegun", u kërkua nga dekanatet përcaktimi i stafit përgjegjës i cili zhvillon lëndët, si dhe caktimin e stafit që do të bënte vlerësimin e kolegut sipas formatit të miratuar nga NJSBC. Drejtuesit e njësive kryesore dhe bazë, gjykuan se formularët nuk kishin nevojë për rishikim dhe mund të përdreshin për grumbullim informacioni sipas formatit aktual. Nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit, u propozua me qëllim marrjen e një feedback-u sa më real të zhvillimit të mësimin në klasa, evidentimit të problematikave të mundshme etj, kryerjen e këtij procesi nëpërmjet një "komisioni" vlerësimi. Përmbatja e këtij komisioni mbulon profilet e lëndëve për degët e studimit Arkitekturë, Dizajn dhe Inxhinieri. Ndërkohë që Fakulteti i Kërkimit dhe Zhvillimit dhe Fakulteti Planifikimi, Mjedisit dhe Manaxhimit Urban, vijuan procesin për këtë komponent sipas hapave standard të parashikuar nga njësia, duke vendosur në dispozicion të dhënat e kërkuara nga NJSBC. Pas një diskutimi të brendshëm, NJSBC gjykoi se ndryshimi i propozuar nga FAD të testohet këtë semestër dhe të konsiderohet si pilotim, me qëllim që në rast se rezultoni i suksesshëm dhe efektiv të përdoret në vijim edhe nga dy fakultetet e tjera. NJSBC ngarkoi në sistemin PITAGORA, formularin e vlerësimit të studentëve për stafin akademik dhe formularin e vlerësimit që kolegu realizon për kolegun. Gjithashtu nëpërmjet postës elektronike, njoftoi nisjen e procesit dhe kërkoi bashkëpunimin e stafit/studentëve duke i sqaruar ata se të dhënat e fituara nga këta pyetësorë, pas përpunimit gjetet përpilohen në formën e një raporti nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) dhe i bëhen të ditura dekanateve/departamenteve përkatëse ku më pas çdo njësi kryesore në bashkëpunim me departamentin komunikojnë në formë individuale me secilin staf për ti bërë të ditur vlerësimin e marrë si dhe bëjnë vlerësimin e performancës akademike të gjithsecilit. Stafi dhe studentët u sqaruan edhe se përmbajtja e pyetësorëve është standarte dhe konsiston me një interval vlerësimi nga 1 (minimumi i vlerësimit) deri te 5 (maksimumi i vlerësimit). Plotësimi i pyetësorit është konfidencial dhe plotësohet në mënyrë elektronike në sistemin PITAGORA (për këtë arsye u vendos në dispozicion Manuali PITAGORA). Ndërkohë që formuali i vetëvlerësimit u shpërnda nëpërmjet Google Form. Përgjatë procesit NJSBC në mënyrë të vazhdueshme si dhe në bashkëpunim me koordinatoret e secilit program, ZMSKK, rektoratit, njoftimeve në rrjetet sociale nxiti pjesëmarrjen e studentëve në këtë proces. Në përfundim të afatit, u shkarkuan nga sistemi PITAGORA të dhënat e grumbulluara dhe nisi procesi i përpunimit të tyre. Duke qenë se të dhënat janë sensitive, u mbajtën konfidenciale përgjatë fazës përpunimit. Paraqitja e rezultateve u bë në dy formate, për secilin program në vecanti:

- Raport i përmbledhur me pjesëmarrjen e studentëve krahasuar totalit të regjistruar për lëndë dhe komponentët e vlerësimit;

- Raporti më i zgjeruar, i cili përmban komentet e studentëve dhe tri komponentët e vlerësimit.




Grafiku nr. 1 Pjesëmarrja studentore për vitin akademik 2024-2025 ne Universitetin POLIS



Grafiku nr. 2 Pjesëmarrja studentore për vitin akademik 2024-2025 sipas fakulteteve


Shic vihet re nga figura nr. 2 dhe figura nr. 3, pjesëmarrja e studentëve në procesin e vlerësimit të performancës së mësimdhënies është konsiderueshëm më e ulët përgjatë semestrit të dytë të vitit

akademik 2024-2025 krahasuar me semestrin e parë për shkak se ky vit nuk ishte një vit i zakonshëm. Ndryshe nga semestrat e mëparshëm, pjesëmarrja studentore në nivel universiteti dhe fakultetesh për semestrin e dytë të vitit akademik 2024-2025 paraqitet e ulët. Ky nivel i ulët lidhet kryesisht me faktin që në të njëjtën periudhë ASCAL shpërndau pyetësonin për realizimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS) tek studentët e të gjithë programeve e të të gjitha cikleve. Duke qënë se rëndësia e plotësimit të këtij pyetësoni është e madhe, *Koordinatorët e Programeve, Përgjegjësit e Departamenteve, NJBSC, ZMSKK, Senati Studentor u përkushtua* gjatë kësaj periudhe në informimin dhe sensibilizimin e studentëve për tu bërë pjesë e këtij sondazhi. Bazuar në të dhënat e përpunuara dhe analizuara, pasqyruar nëpërmjet grafikëve të mëposhtëm tregohet vlerësimi i stafit sipas komponentëve të vlerësimit (mesatar) për secilin fakultet në nivel programi.



Grafiku nr. 3 Rezultatet e vlerësimit në nivel programi për FPMMU, Semestri I 2024-2025


FPMMU - VLERËSIMI I STAFIT SIPAS KOMPONENTËVE Semestri II, 2024-2025




Grafiku nr. 4 Rezultatet e vlerësimit në nivel programi për FPMMU, Semestri II, 2024-2025

Sipas grafikut nr. 2, për semestrin e parë vlerësimi më i ulët nga studentët është shënuar në programin Bachelor në Administrim Biznesi (4.69) dhe më i larti në programin Master Shkencor në Manaxhim Mjedisor Urban. Lidhur me semestrin e dytë luhajta më e madhe shënohet në komponentin e vlerësimit “kolegu për kolegun”. Sipas grafikut nr. 3, niveli më i ulët i vlerësimit për këtë komponentë është shënuar në programin 5 vjecar “Planifikim dhe Manaxhim Urban” (4.19) dhe më i larti është shënuar në programin Master Shkencor në Administrim Biznesi (4.73). E rëndësishme për t’u përmendur është se në FPMMU për të dy semestrat asnjë prej komponentëve nuk na rënën nën nivelin 4 të vlerësimit i cili është niveli dysHEME.

FKZH - VLERËSIMI I STAFIT SIPAS KOMPONENTËVE Semestri I, 2024-2025




Grafiku nr. 5 Rezultatet e vlerësimit në nivel programi për FKZH, Semestri I 2024-2025



Grafiku nr. 6 Rezultatet e vlerësimit në nivel programi për FKZH, Semestri II 2024-2025


Sipas grafikut nr. 5, për semestrin e parë, në FKZH vlerësimi më i ulët nga studentët është shënuar në programin Bachelor në Shkenca Kompjuterike (4.6) dhe më i larti në programin Master Shkencor në Shkenca Kompjuterike. Ndërkohë që, lidhur me semestrin e dytë luhajta me e madhe shënohet në komponentin “kolegu për kolegun. Sipas grafikut nr. 6, niveli më i ulët i vlerësimit për këtë komponent është shënuar në programin Master Shkencor në Shkenca Kompjuterike (3.27) dhe më i larti është shënuar në programin Bachelor në Shkenca Kompjuterike (4.66). Ndryshe nga fakulteti FPMMU, në FKZH njëri prej komponentëve ka rënë nën nivelin 4 të vlerësimit i cili është niveli dysHEME dhe kërkon analiza të detajuar lidhur me shkaqet dhe marrjen e masave për përmirësim nga ana e departamentit dhe dekanatit përkatës.

FAD - VLERËSIMI I STAFIT SIPAS KOMPONENTËVE Semestri I, 2024-2025



Grafiku nr. 7 Rezultatet e vlerësimit në nivel programi për FAD, Semestri I 2024-2025

FAD - VLERËSIMI I STAFIT SIPAS KOMPONENTËVE Semestri II, 2024-2025



Grafiku nr. 8 Rezultatet e vlerësimit në nivel programi për FAD, Semestri II 2024-2025

Sipas grafikut nr. 7, për semestrin e parë, në FAD vlerësimi më i ulët nga studentët është shënuar në programin Bachelor në Art Dizajn (4.32) dhe më i larti në programin Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi. Ndërkohë që, lidhur me semestrin e dytë, nëse referohemi grafikut nr. 8 nuk ka luhatje të asnjë komponenti në asnjë prej programeve, asnjë prej tyre nuk ka shënuar nivele nën

kufirin 4, ndërkohë që niveli maksimal 5 është shënuar në programin Master Shkencor në Dizajn të Aplikuar.

Në përfundim të përpunimit të të dhënave lidhur me procesin periodik të vlerësimit të mësimdhënies së stafit akademik për vitin akademik 2024-2025, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë hartoi raporte semestrale në të cilat përveçse analizoi të dhënat dhe i pasqyroi ato në një formë për të qënë të kuptueshme nga të gjitha palët e interesuara, evidentoi disa problematika kryesisht administrative lidhur me procesin. Me qëllim pasqyrimin e një situatë sa më të saktë, të vërtetë dhe të sinqertë, si dhe përmirësimin e cilësisë hartoi disa rekomandime të cilat gjenden në seksionin 4.

3.3 Ndërkombëtarizimi

Prej muajit janar 2025, Universiteti POLIS është bërë pjesë e Aleancës Universitare BAUHAUS4EU, e cila përbëhet nga 10 universitete të cilat së bashku kanë një rrjet prej 124,000 studentësh dhe 10,000 staf akademik, të cilët janë zotuar të punojnë së bashku në drejtim të mësimdhënies, mësimnxënies, kërkimit dhe inovacionit. Nëpërmjet këtij projekti Universiteti POLIS synon përmbushjen e disa prej objektivave kryesor strategjik, të përcaktuar edhe në Strategjinë e Zhvillimit si: pasurimi i ofertës akademike nëpërmjet programeve të përbashkëta (joint-degree) me partnerët, modernizimin e kurrikulave fillimisht nëpërmjet ofrimit të Bauhaus Courses (për lëndët më zgjedhje) të cilat fillojnë zbatimin në semestrin e parë të vitit akademik 2025-2026, ofrimin e oportuniteteve për të mësuarin gjithpërfshirës dhe fleksibel (micro-dredentials), ndërtimin dhe integrimin e platformës së përbashkët të menaxhimit, harmonizim të procedurave që lidhen me sigurimin e cilësisë me qëllim përfundimtar adoptimin e unifikuar të Sistemit Europian të Sigurimit të Cilësisë dhe Njohjes¹⁰ që mundëson Joint European Degree që është edhe qëllimi për të cilin BE ka nxitur dhe financuar Aleancat Universitare Europiane, rritje e mobilitetit të stafit dhe studentëve, mundësi për kërkim e inovacion, unifikim të kampuseve universitare etj.

Përgjatë vitit akademik 2024-2025, Universiteti POLIS mirëpriti 14 studentë francez nga institucionet partnere në programin Erasmus ISB, ICD, IGS-CIEFA dhe ADIP. Studentët, të cilët përfshihen në profilin Master Administrim Biznesi qëndruan për 2 muaj të plotë, deri më 29 nëntor 2024. Gjatë kësaj periudhe, në Universitetin Polis, ata u fokusuan në zgjerimin e njohurive të tyre rreth biznesit me ndihmën e kurseve specifike të ofruara si Liderhipi, Strategji Biznesi, Menaxhim i Projekteve etj.

¹⁰ <https://education.ec.europa.eu/education-levels/higher-education/joint-european-degree/quality-assurance-and-recognition>

3.4 Akreditime

Përgjatë vitit akademik 2024-2025, Universiteti POLIS ishte subjekt akredimi në nivel programi për 4 programe, më konkretisht:

Nr.	Programi	Tipi i akreditimit	Ecuria deri më 05/09/2025
1	Bachelor në Administrim Biznesi	Akreditim per here te pare	Dërguar RVJ Final – Dërguar komentet mbi rekomandimet e lëna nga GVB
2	Bachelor në Art dhe Dizajn	Riakreditim	Vendim Bordi Akreditimit nr. 119, datë 20.06.2025
3	Master Shkencor në Dizajn të Aplikuar	Riakreditim	Dërguar RVJ Final – Dërguar komentet mbi rekomandimet e lëna nga GVB
4	Master Shkencor në Manaxhim Mjedisor Urban	Riakreditim	Dërguar RVJ Final – Dërguar komentet mbi rekomandimet e lëna nga GVB

Koordinatori i Universitetit POLIS ndoqi në përputhje me Manualin e Cilësisë komunikimin me ASCAL përgjatë gjithë hapavë të procesit të akreditimit për të 4 programet nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të ASCAL (ASCAL Management System – AMS). Në përputhje me Manualin e Cilësisë së ASCAL, nën mbikqyrjen e NJBCS, e cila në këtë proces luan një rol të rëndësishëm sa i përket mirë-manaxhimit të afateve dhe ndjekjes me përpikmëri të hapave të punës. NJBSC pati takime të frytshme dhe pozitive me secilin GVJ bazuar në agjendat përkatëse për secilin program studimi.

Për vitin e ardhshëm akademik, 2025-2026, Universiteti POLIS ka kryer aplikimin për akreditimin periodik të dy programeve si me poshte te cilat kanë jane në vitin e fundit përpara përfundimit të akreditimit të periodic ne fuqi:

Nr.	Programi	Tipi i akreditimit
1	Programi i ciklit të tretë PhD në Arkitekturë dhe Planifikim Urban https://universitetipolis.edu.al/wp-content/uploads/2023/04/Vendim-Nr.-29-date-03.03.2023-Akreditim-Periodik-PHD-Arkitekture-dhe-Planifikim-Urban.pdf	Akreditim periodik (akreditim i vlefshëm deri më 02/03/2026)
2	Programi i studimit me karakter profesional Mirëmbajtje e Rrjeteve Kompjuterike https://universitetipolis.edu.al/wp-content/uploads/2023/05/ASCAL--Vendim-Akredimi-Mirembajte-Rrjete.pdf	Akreditmi periodik (akreditim i vlefshëm deri më 21/04/2026)

NJBSC dhe Universiteti Polis, njekohesisht vijojnë punën për plotësimin e detyrave të lëna nga QAA, në përputhje me Planin e Veprimit¹¹ të hartuar bazuar në rekomandimet e lëna në raportin e lëshuar më datë 21.12.2023. Agjensia Britanike (QAA) përgjatë vitin 2026 do të zhvilloi fizikisht vizitën e kontrollit periodik për akreditimin institucional.

3.5 Dixhitalizimi

Në kuadër të dixhitalizimit universiteti ka ndërmarrë hapa konkretë në dy drejtime: se pari lidhur më trajnimin e stafit akademik/ administrative mbi risite teknologjike, vecanerisht përhapjen e inteligjencës artificiale dhe se dyti, në dixhitalizimin e disa prej proceseve kryesore të punës.

Sa i përket trajnimeve përgjate vitit akademik 2024-2025, stafi akademik ka zhvilluar dy trajnime:

- “AI for Academic Institutions: Leveraging AI and ChatGPT for Teaching” – Prof. Ardiana Sula – University of New Haven, zhvilluar mw datw 28/02/2025;
- “AI, shoqëria, zhvillimi dhe universitetet e të ardhmes: si na impakton në POLIS? Çfarë duhet bërë?” – Dr. Emiliano Mankolli, zhvilluar mw datw 27 Gusht 2025.

Në drejtim të dixhitalizimit të proceseve të punës, administrative dhe akademike, Universiteti POLIS ka bërë hapa konkret kryesisht të mbështetur edhe nga projektet e ndihmës së huaj. Vleresimi i kërkimit shkencor deri në semestrin e parë të këtij viti akademik është kryer nga "manualisht" nëpërmjet plotësimit të tabelave që dërgoheshin me email pranë çdo stafi akademik, i cili vetë deklaronte aktivitetin shkencor të kryer përgjatë një viti. Në kuadër të projektit QA-SURE i cili synon përmirësimin e zyrave të NJSBC për disa IAL të rajonit ballkanit nepermjet asistences 2 partnereve europian, u prokurua nje softëare i dedikuar për kërkimin shkencor UCRIS. Të gjithë anëtarët e stafit akademik të Universitetit POLIS, që prej muajit Maj 2025 janë pajisur me user/fjalëkalime personale për të aksesuar sistemin me qëllim ngarkimin e të gjithë punimeve akademike e shkencore (artikuj, projekte, monografi etj.), sipas fushave të përcaktuara. Sistemi UCRIS përveçse lehtëson universitin dhe NJSBC në përmbushjen e një detyrim ligjor që i përket për çdo IAL, shërben edhe si një arkivë elektronike personale për secilin pjesëtar të stafit akademik. Ky sistem gjeneron raporte te ndryshme bazuar ne nevojat e NJSBC. Një nismë tjetër e ndërmarrë nga Universiteti në përmushje të objektivave strategjik lidhur me dixhitalizimi, është ndërtimi i një database elektronike me te gjithë titujt e librave fizik qe gjendjen ne Biblioteken U_POLIS. <https://www.libib.com/u/polis> Iniciative të ngjashme, zyra e IT dhe sekretaria mësimore po bëjnë lidhur me dixhitalizimin e proceseve që lidhen me manaxhimin e orarit mësimor si rakordimi stafit, koordinimi klasave, grupeve të studentëve tj.

¹¹ https://universitetipolis.edu.al/wp-content/uploads/2024/01/QAA_Action-Plan_2024.pdf

3.6 Kërkimi Shkencor

Universiteti POLIS është i mirëpozicionuar në Albanian National H-index Ranking 2025. Kërkimi shkencor incentivohet dhe vlerësohet financiarisht, veçanërisht publikimet cilësore të rankuara nga Scopus dhe Web of Science (“Clarivate Analytics”). Lidhur me sa më sipër prej Janar 2023 është vendosur në zbatim direktiva e Universitetit Poliss “Për promovimin e publikimeve shkencore dhe veprimtarive shkencore ndërkombëtare”, objekti i të cilës është përcaktimi i metodave dhe parimet për nxitjen e stafit akademik të Universitetit POLIS për të kryer botime dhe për të marrë pjesë në veprimtari shkencore në nivelet ndërkombëtare.

Në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit dhe në kuader të përmbushjes së objektivave strategjik lidhur me kërkimin shkencor, nën udhëheqjen e FKZH gjatë vitit akademik 2024-2025, ka nisur puna për ngritjen e grupeve kërkimore në nivel Universiteti. Fillimisht u ndërtuar një instrument i thjeshtë (matricë) që kryqëzon “research pillars” me interesa të mundshme kërkimore të stafit që ndihmoi në iniciimin e krijimit të grupeve ose “alcove” kërkimore mes stafit të POLIS duke përfshirë, veçanërisht, edhe studentët e doktoraturës. Matrica do të jetë objekt ndryshimesh pasi gjykohet se grupe kërkimore nuk janë statike, por dinakime dhe synohet detektimi i konstelacione të mundshme kërkimore në vijueshmëri. Cdo staf akademik pozicionoi veten bazuar në interesin e tij kërkimor, dhe më pas të tjerë e “populluan” atë me interesat kërkimore që përputhen duke krijuar kështu grupe me dy, tre ose më shumë partnerë kërkimor. Në vijim të draftit të parë, stafi u mbledh më 24 Prill 2025 për të diskutuar më në detaje dhe konkludoi me krijimin e 6 grupeve kërkimore të mëposhtme:

Nr.	Shtyllat kerkimore	Drejtuesit e grupeve kërkimore
1	Art and Architectural history, and design theories and methodologies	Prof.As. Skender Luarasi / Dr. Sonia Jojic
2	Design and theories of urban form: the sustainability of settlements in history	Prof.As. Sotir Dhamo / Dr. Ledian Bregasi
3	Innovative building technologies and materials	Prof.As. Merita Guri / Dr. Klodjan Xhexhi
4	Cultural heritage. Restoration History and Theory and Technologies	Prof.As. Llazar Kumaraku / Dr. Nikolla Vesho
5	Business models in the construction, ICT, and Innovation industry	Prof.As. Xhimi Hysa / Dr. Ilda Rusi / Dr. Albina Tocilla
6	Urban analytics, territorial governance, and resilience	Prof. Emer. Dr. Sherif Lushaj / Prof. Assoc. Dr. Godiva Rëmbeci / Dr. Dorian Musai

4. REKOMANDIME

- Njësitë kryesore (dekanatet) përpara ngarkimi të “Formularit të vlerësimit nga studentët për stafin akademik” dhe “Formularit të vlerësimit që kolegu realizon për kolegun” duhet të verifikojnë dhe validojnë të dhënat (titullar, staf ndihmës akademik, lëndë etj.) që përmban sistemi PITAGORA në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore;

- Rekomandohet përdorimi i formularëve të miratuar nga NJBSC “Për përcaktimin e stafit përgjegjës i cili zhvillon lëndën, si dhe caktimin e stafit që do të bëjë vlerësimin e kolegut” (shih Aneks nr. 4) për përcjelljen e informacionit paraprak, me qëllim lehtësimin e procesit dhe shmangien e problematikave që lidhen me kryqëzimin e lëndës me stafin e anagzhuar në secilën lëndë;
- Nxitja e stafit PAK/PAE për plotësimin e formularit të vetëvlerësimit, i cili rezulton në nivele të ulta;
- Njësitë kryesore FAD, FPMMU, FKZH nxisin stafin të kryej procesin e vlerësimit kolegu për kolegun (së paku për titullarët e çdo lënde), komponent ky që mban 35% të vlerësimit, pasi aktualisht pjesëmarrja në këto tri fakultet është nën 40%.
- Njësia kryesore FAD të vijojë testimin e komponentit “peer review” nëpërmjet “komisioni të vlerësimit”, bazuar nga të dhënat e grumbulluara nga ky proces pilotimi, NJSBC do të vlerësojë efektivitetin dhe do të vendosë nëse përgjatë vitit të ri akademik 2025-2026 nëse kjo metodë do të përdoret edhe nga dy fakultetet e tjera, FKZH dhe FPMMU;
- Njësitë kryesore të analizojnë të dhënat e dërguara nga NJSBC në nivel fakulteti me qëllim marrjen e masave për përmirësim, rishikim apo motivim;
- Njësitë bazë të analizojnë rezultatet në nivel program, të përcjellin informacionin e detajuar pranë secilit staf, si dhe të zhvillojnë takime bilaterale për të diskutuar nga afër rezultatin dhe përcaktimin e hapave/afateve të mëtejshme sidomos për vlerësimet nën 4 pikë dhe ku pjesëmarrja ka qënë në nivele të ulta;
- Rekomandohet njësitë kryesore dhe bazë të nxisin stafet akademike të ngarkojnë në sistemin e kërkimit shkencor UCRIS aktivitetin e tyre me qëllim krijimin e një database dhe gjenerimin e raporteve sipas nevojave në kohë reale;
- Rekomandohet zhvillimi i takimeve në nivel grupi kërkimor sipas tematikave të specifikuara në seksionin 3.6 nën drejtimin e drejtuesit me qëllim shprehjen e interesave të përbashkëta dhe/apo nevojave për kooperim;
- Nisur nga suksesi që pati zhvillimi i një semesëtri nga studentët francez, të shihen mundësitë për të intensifikuar marrëdhëniet e ngjashme, të cilat sjellin vlerë të shtuar për studentët, stafin, ofertën akademike dhe rrisin mundësitë për afrimin e studentëve cilësor nga vendet e BE.
- Rekomandohet Bibloteka U_POLIS të vijojë punën për pasqyrimin e të gjithë kopertinave (pjesa e mbetur) në <https://www.libib.com/u/polis/1/1665833> dhe informimi i stafit e studenteve në rrugë zyrtare se kanë mundësi që përpara se të huazojnë libra fizikisht nga bibloteka mund të informohen paraprakisht duke aksesuar biblotekën virtuale në linkun përkatës.
- Rekomandohet Bibloteka U_Polis të përgatisë një broshurë të re informuese (guida e biblotekës) duke qënë së ka patur risi/ndryshime në këtë drejtim.

5. ANEKSE

Aneksi nr. 1

FORMULAR PËR VETËVLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË LEKTORIT

ACADEMIC YEAR 2024-2025

Emri i lektorit: _____

Lënda: _____

Jeni të lutur të vlerësoni performancën tuaj në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, në shkallën 1 deri në 5, sipas çelësit të mëposhtëm, duke u bazuar në pyetjet për secilin aspekt:

1: Pamjaftueshëm; 2: Mjaftueshëm; 3: Mirë; 4: Shumë mire; 5: Shkëlqyeshëm

Ky formular vetëvlerësimi është për të bërë një autorefleksion se sa janë arritur objektivat e vëna nga vetë lektori në fillim të procesit mësimor dhe arritjet e tij në fushën kërkimore shkencore.

PERFORMANCA E PËRGJITHSHME		VLERËSIMI				
1	Përgatitja për lëndën	1	2	3	4	5
2	Materiali mësimor i përdorur për lëndën është i mjaftueshëm dhe cilësor	1	2	3	4	5
3	Jeta organizative (marrëdhëniet me eprorët, kolegët, stafin e U_POLIS)	1	2	3	4	5
4	Atmosfera në auditor gjatë shpjegimit të lëndës	1	2	3	4	5
5	Qartësia e shpjegimit të lëndës	1	2	3	4	5
6	Ndihmesa ndaj studentëve, jashtë orës mësimore	1	2	3	4	5
7	Marrëdhënia pedagog-student	1	2	3	4	5
8	Qartësia e udhëzimeve mbi detyrat	1	2	3	4	5
9	Respektimi i orareve mësimore	1	2	3	4	5
10	Kontributi në fushën kërkimore shkencore	1	2	3	4	5
11	Kriteret për vendosjen e notave janë të qarta dhe të njohura për studentët	1	2	3	4	5
12	Etika e komunikimit me studentët	1	2	3	4	5

Shënim: Mesatarja e Vlerësimit të Pedagogut përbëhet nga :

50% - Vlerësimi nga Studentët

35% - Vlerësimi nga Kolegët

15 % - Vetëvlerësimi

Aneksi nr. 2

FORMULAR PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË KOLEGUT NË PROCESIN MËSIMOR

2024 - 2025 ACADEMIC YEAR

Emri i lektorit: _____
Lënda: _____
Nr. studentëve: _____
Nr. studentëve të pranishëm: _____
Koha e fillimit të leksionit: _____
Koha e përfundimit të leksionit: _____
Data e vlerësimit: _____

Jeni të lutur të vlerësoni aspektet e mësimdhënies së lektorit, në shkallën 1 deri në 5, sipas çelësit të mëposhtëm, duke u bazuar në pyetjet për secilin aspekt:

1: Pamjaftueshëm; 2: Mjaftueshëm; 3: Mirë; 4: Shumë mire; 5: Shkëlqyeshëm

Pyetja (në total) – vlerëso duke rrethuar!

Alternativat a, b, c, d vlerësoji në tabelën anësore nga 1-5 sipas çelësit të mësipërm!

Pyetja 1. Planifikimi i leksionit

a	A janë njoftuar studentët paraprakisht për orën dhe mënyrën e zhvillimit të leksionit?	1	2	3	4	5
b	Si qëndron tema e leksionit në përputhje me parashikimet në syllabusin e lëndës?	1	2	3	4	5
c	Metodat e mësimdhënies a janë të përshtatshme për temën e trajtuar në leksion?	1	2	3	4	5
d	A është lektori i mirëpërgatitur dhe i mirëorganizuar?	1	2	3	4	5

Pyetja 2. Mjedisi i mësimi/Platforma online

a	A vendos lektori marrëdhënie komunikimi me studentët?	1	2	3	4	5
b	A është lektori i motivuar për të dhënë mësim, si edhe për të dëgjuar studentët?	1	2	3	4	5
c	A e nxit lektori pjesëmarrjen e studentëve dhe a u përgjigjet siç duhet pyetjeve?	1	2	3	4	5

Pyetja 3. Zhvillimi i leksionit

a	A ka një rrjedhë logjike të të shpjeguarit gjatë leksionit?	1	2	3	4	5
b	A u jepet mundësia studentëve për të menduar, pyetur dhe reaguar gjatë leksionit?	1	2	3	4	5

c	A është e përshtatshme gjuha dhe shpejtësia e të folurit të lektorit për nivelin e studentëve?	1	2	3	4	5
d	Salla në të cilën zhvillohet mësimi është i përshtatshëm për zhvillimin e leksionit	1	2	3	4	5

Pyetja 4. Përfundimi i leksionit

a	A përfundon leksioni në mënyrë logjike?	1	2	3	4	5
b	A bëhet përmbledhja e ideve ose e pikave kryesore të leksionit?	1	2	3	4	5
c	A sugjerohen lexime apo jepen detyra në lidhje me temën e trajtuar?	1	2	3	4	5

Pyetja 5. Baza materiale

a	A ka përgatitur pedagogu leksione të shkruara/dispecë?	1	2	3	4	5
b	A janë hedhur materialet mësimore në platformën online/ ose janë vënë në dispozicion në një formë tjetër?	1	2	3	4	5
c	A janë vënë studentët në dijeni për përdorimin e dy platformave e-library, EBSCO dhe JSTORE	1	2	3	4	5

Komente të përgjithshme mbi pikat e forta dhe dobëta të lektorit. Sugjerime nga kolegu mbi çfarë duhet përmirësuar nga ana e lektorit, pas zhvillimit të bisedave të lira me studentët lidhur me përfitimin profesional në raport me lëndën që vlerëson.

Emër Mbiemër

Firmë

Fomular vlerësimi për pedagogun

Lënda:

Programi:

Pedagogu:

Viti akademik:

Ju lutemi vlerësoni nga numrat 1-5 me anë të cilit ju shprehni vlerësimin tuaj për pedagogun.

1= minimumi i vlerësimit 5= maksimumi i vlerësimit

1. Pedagogu ka njohuri të thelluara për lëndë dhe është përgatitur për orën e mësimit

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

2. Shpjegimi i pedagogut është i qartë dhe i kuptueshëm

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

3. Pedagogu përdor shembuj për ta bërë lëndën sa më të lehtë e të kuptueshme

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

4. Pedagogu stimulon interesin për lëndën

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

5. Pedagogu ju inkurajon për ti bërë pyetje dhe ju përgjigjet atyre plotësisht

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

6. Pedagogu është i gatshëm t'i ndihmojë studentët kur ata kanë nevojë edhe jashtë orës së mësimit

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

7. Materiali mësimor i përdorur për lëndën (lesione, ushtrime, detyra) është i qartë, i mjaftueshëm dhe i dobishëm.

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

8. Materialet janë të aksesueshme në platformën online

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

9. Salla ku zhvillohet mësimi është e përshtatshme për zhvillimin e lëndës

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

10. Si është etika e komunikimit të pedagogut me studentët

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

11. Lënda është interesante dhe na shërben për formimin profesional

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

12. Sylabusi/mënyra e vlerësimit u shpjegua në fillim të lëndës.

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

13. Vlerësimi i lëndës u bë në përputhje me sylabusin

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

14. Pedagogu është i barabartë në vlerësim për të gjithë studentët

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

15. Ju lutemi shtoni pyetjet që ju mendojnë se mungojnë dhe karakterizojnë pedagogun tuaj si dhe/ose bëni komente të tjera rreth vlerësimit të pedagogut.

Aneksi nr. 4

 Fakulteti Për përcaktimin e stafit përgjegjës për vlerësimin e kolegut për kolegun Viti akademik 2024-2025 Semestri i Parë			
Nr.	Lënda	Lektori i lëndës	Lektori që do të bëjë vlerësimin
	Arkitekturë 1		
1			
2			
3			
4			
5			
	Arkitekturë 2		
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			
	Arkitekturë 3		
1			
2			
3			
4			
5			
	Arkitekturë 4		
1			
2			
3			
4			
5			
	Arkitekturë 5		
1			
2			
3			
4			
5			